



Minutat e takimit në komunën e Drenasit

Datë: 30.01.2018

Pjesmarrës: Afrim Prokshi (DSHPE-Drenas); Ariana Sadiku (D. INSPEKSIONIT-Drenas); Muhamer Çela (KRM PASTRIMI-Drenas); Hazir Elshani (DKA-Drenas); Shpend Bogiqi (DSHPE-Drenas); Besart Bajrami (DPUUM-Drenas); Arben Nika (Ojq, CEAE-Drenas); Visar Gashi (Ojq, CEAE-Drenas); Merlina Beu-Muçaj (Drejtoreshë e GAC, Prishtina); Pajtim Kastrati (Koordinator lokal për Drenas i GAC, Prishtina); Ron Aruqaj (GAC, Prishtina)

Në takimin e mbajtur me grupin punues të komunës së Drenasit, fillimisht mori fjalën z. Prokshi, i cili shprehu falendërimin për angazhimin e vazhduar deri me tani, pastaj shpalosi edhe punën e deritanishme që është arritur në komunën e Drenasit në kuadër të projektit “Zbatimi i skemes se ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim”. Sipas tij janë rishikuar të gjitha pikat e draftit të propozuar nga ekspertet e angazhuar nga GIZ. Po ashtu ritheksoj edhe rregullimin e 11 pikave të kontejnerëve 1.1m³ në qendër, ku është rregulluar platforma e tyre, ndërsa 3 pika prej tyre do të mbulohën të cilat i financon GIZ-SMS project. Forma apo modeli i mbulojes, tashmë është aprovuar edhe nga ana e komunës. Sa i përketë pikave tjerë mbetet që në vazhdim të procesit të mbulohen nga buxheti i komunës së Drenasit. Në bazë të z. Prokshaj, komuna e Drenasit planifikon t’i ndaj rreth 4000 €, për rregullimin e pikave të kontejnerëve, ndërsa në bazë të takimeve që kanë realizuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ata kanë premtuar që komunën në fjalë do ta subvencionojnë më 25000€, për rregullimin e pikave të kontejnerëve 1.1m³.

Drejtoresha e GAC, znj. Beu-Muçaj shprehu falendërimin ndaj grupit punues për kohën dhe angazhimin e vazhduar që kanë treguar deri më tani sa i përketë projektit. Drejtoresha në pika të shkurtër prezantoi draftin final për pikat e gjetura dhe të propozuara nga ana e ekspertëve të GIZ, numrin e kontejnerëve 1.1m³, që janë llogaritur të vendosen në 16 pikat e propozuara, prej tyre sa parashihen të jenë për mbeturina të riciklueshme dhe sa të pariciklueshme, numrin e kontejnerëve 120 l për ekonomi familjare, etj.. Gjithashtu u diskutua edhe një pikë e cila është propozuar të shërbehet më kontejnerë 240 l, për shkak pamundësisë së vendosjes së 1.1m³ në hapësirën e ngushtë. Diskutabile mbetet edhe një pikë, në të cilën objekti është në ndërtim e sipër dhe koha e mbarimit të ndërtimit nuk dihet.

Në komunën e Drenasit nuk ekzistojnë mbledhës joformal të komunitetit RAE apo edhe të shqiptarëve, përveq një “kompanie” private të drejtuar nga z Ramiz Mehani nga Çikatova e vjetër, i cili që 15 vjetë merrët me grumbullimin e metaleve dhe 7 vjetë me vonë me grumbullimin e të gjitha llojeve të plastikës. U diskutua në takim rreth punës së personit në fjalë dhe shikimi së si të gjejmë një marveshje të kyqjes së tij në mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme në qoftë se KRM PASTRIMI në Drenas nuk ka kapacitet të grumbullimit të këtyre mbetjeve. U dhanë propozime të



ndryshme nga anëtarët e grupit punues si dhe nga drejtori i KRM PASTRIMI z. Çelaj, se si të funksionojnë se si të funksionojnë si kompani publike dhe e vetme më operim në territorin e komunës së Drenasit. Një propozim ishte që kompania PASTRIMI, t'i grumbulloj këto mbetje të riciklueshme dhe t'i shkarkoj në pikën transferuese që e kanë afer Feronikelit dhe pastaj kjo "kompani" private t'i selektoj mbeturinat e riciklueshme dhe t'i marr, fillimisht falas dhe pas një periudhe ose t'ia shesin ose t'i selektoj vet KRM PASTRIMI. Me këtë propozim llogaridhënja e kompanisë private shkon tek kompania PASTRIMI, pasi që do të jetë nën monitorimin e tyre, ndërsa kompania PASTRIMI nën monitorimin e komunës. Tjetër propozim ishte që kjo kompani private të filloj grumbullimin e mbetjeve në terren, por nën monitorimin e kompanisë PASTRIMI në Drenas.

Nga ana e z. Prokshit, u propozua që të thirret z. Mehani në një takim formal me grupin punues dhe të shikohën mundësitë e bashkpunimit më marrveshje të përbashkët nga të tri palët Komuna, PASTRIMI dhe kompania private.

Znj. Beu-Muçaj theksoj edhe vazhdimin e aktiviteteve informuese, vetëdijesuese të cilat do t'i aranzhoj koordinatori lokal për Drenas Pajtim Kastrati së bashku me GAC dhe në bashkpunim me komunën e Drenasit, me qëllim rritjen e cilësisë së ndarjes së mbetjeve të riciklueshme në këtë komunë. Aktivitetet të cilat do të vazhdojnë janë takimet e njëpasnjëshme me qytetarët, ku këto takime do të jenë në formë të ndryshme, qoftë gruporë qoftë individuale, derë më derë, etj.. po ashtu aktiviteti me Klubet e Gjelbra do të vazhdoj, me anë të trajnimeve, takimeve dhe aktivitete tjera. Pra më këtë do të bëhet edhe monitorimi i vazhduar i procesit të ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim.

Nga: Pajtim Kastrati – koordinatori lokal, Drenas (GAC, Prishtina)

